



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"**

*Mv 593 Prot*

*dt 23.04.2018*

**VENDIM**

Nr. 11 \_ Data 05.04.2018 \_

**Për shtyrjen e vendimmarrjes në mbledhjen e rradhës të kërkesës, për shfrytëzim të burimit ujqor në lumin e Kardhiqit , dega e lumit Drino, për ndërtimin e hidrocentralit "Ferko 2" për prodhim të energjisë elektrike, Fshatin Çepu , Bashkia Gjirokastër, Qarku Gjirokastër, subjektit "SUFER" sh.p.k., me administrator Z. Ferit SUKAJ.**

Në bazë të ligjit **Nr.111/2012 datë 15.11.2012** "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të **V.K.M 416 datë 13.05.2015** "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", formulari D, dokumentacioni teknik, Vendimit **Nr. 876, datë 14.12.2016** "Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative" si dhe Vendimit **Nr. 662 datë 21.09.2016** "Miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta", Vendimit **Nr.5 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujqor", Vendimit **Nr.6 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjensisë së Basenit Ujqor"; V.K.M Nr.822, datë 07.10.2015, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", shkresës zyrtare të Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, **Nr. 526, datë 21.10.2016 "Vënie në dijeni"**,

**VENDOSI**

Për shtyrjen e vendimmarrjes në mbledhjen e rradhës të kërkesës, për shfrytëzim të burimit ujqor në lumin e Kardhiqit , dega e lumit Drino, për ndërtimin e hidrocentralit "Ferko 1" për prodhim të energjisë elektrike, Fshatin Çepu , Bashkia Gjirokastër, Qarku Gjirokastër, subjektit "SUFER" sh.p.k., me administrator Z. Ferit SUKAJ me këto të dhëna:

Koordinatat: X 44 19 200 ; Y 44 45 970 ; Z 232

Prurja mesatare : 6.310 m<sup>3</sup>/sek

**Adresa:** Godina e Drejtorisë së Bujqësisë, Kati i parë e-mail: [aubvjosavlore@gmail.com](mailto:aubvjosavlore@gmail.com) Faqe 1 of 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"**

Prurja e llogaritur: 5.810 m<sup>3</sup>/sek

Prurja e ekologjike: 0.607 m<sup>3</sup>/sek

Fuqia e instaluar e hidrocentrali llogaritet të jetë **860 kW**

Ngarkohet ABU për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I K.B.U "VJOSË"**

**Flamur MAMAJ**

**PËRGJEGJËS I A.B.U "VJOSË"**

**Ilir PROFKA**

